



Lushnja i është falur një goli të shënuar nga Bjelkanovic për të marrë tre pike shumë të rëndësishme në luftën për mbijetese. Lagunaret kanë mposhtur skuadrën e Besës që mbetet në vendin e fundit. Të ndihmuar nga tifozet vendas, Lushnja ka shënuar dhe me pas ka menaxhuar të gjithë minutat e pjesës së dytë për ta fituar krejt ndeshjen. Goli në minutën e 18' i ka prerë krahët Besës që pas dy rezultateve pozitive rradhazi ka gjetur serish një tjetër humbje. Lushnja me këto tre pike ka marrë vendin e pestë në klasifikim e tani ka pozita mjaft komode për vazhdimësinë e këtij sezoni.